
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	 PRISHTINA
	Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	

Datë/a:	15.03.2023.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: MILOT GASHI B.I
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Visar Shehu – U.D. - Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 15.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: MILOT GASHI B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si e bazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: MILOT GASHI B.I e parashtruar me datë: 12.10.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me Nr. të Prok: 616-22-83-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës 28.09.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Publik vendos që të bëjë ndryshimet në kriterin e dosjes së tenderit në pikën 9.1 dhe 9.2. në par.1**
3. **Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me Nr. të Prok: 616-22-83-2-1-1**
4. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**